

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sherri me avokatët, GJKKO në kolaps prej rregullores, 3 javë pa gjyqe
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/kronike/sherri-me-avokatet-gjkkko-ne-kolaps-prej-rregullores-3-jave-pa-i1186019
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:28:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a94287945ccd6c7491d26c4588d6c9ec6cea18a8da6e7cd054da0e097f09b5ac
TEKSTI	6beec00c196de25f394a35cdb0e959f943d951622690c82ea5ebc0ea2e3b6c58
PAMJA	5670cde14b1917594591e35b6a7912ea45cd293c7d2f45ca3ffad8d56143b59c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cad50aac995ff492f396c76a87f984e54bd8596680417cf29124dafb76082de0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cad50aac995ff492f396c76a87f984e54bd8596680417cf29124dafb76082de0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Sherri me avokatët, GJKKO në kolaps prej rregullore, 3 javë pa gjyqe



Nga Armand Bajrami
28 Shtator 2026, 17:20 | Kronikë



Gjykata e Posaçme është futur në një ngërç funksional. Prej tre javësh në të nuk është zhvilluar asnjë gjykim në themel. Proceset kanë dështuar për shkak të bojkotit të avokatëve, që kërkojnë rishikim të një rregulloreje të gjykatës. Nga e hëna, avokatët nisën bojkot edhe të seancave të masave të sigurimit.

Një rregullore e re e brendshme në Gjykatën e Posaçme, që nisi të zbatohet prej datës 1 shtator, po e çon këtë gjykatë në kolaps. Të hënën, radha e dështimit të gjyqit i ra mes të tjerëve dosjes "Partizani", kryebashkiakut të Shkodrës, apo edhe Emiliano Shullazit. Proceset në GJKKO, janë në ngërç prej 8 shtatorit, kur avokatët vendosën të bojkotojnë çdo gjykim në themel. Mes bojkotit mbrojtësit kërkojnë rishikim të rregullores, që sipas tyre, i kufizon në ushtrimin e profesionit të avokatit.

Për më shumë se dy javë, bojkoti i avokatëve u injorua nga Gjykata e Posaçme. Në disa seanca mbrojtësit u gjobiten nga gjykata me nga 10-50 mijë lekë me arsyetimin e mungesës së papërligjir.

Më 23 shtator avokatët përshkallëzuan revoltën, duke vendosur të bojkotojnë edhe seancat për caktimin, vlerësimin apo zëvendësimin e masave të sigurisë. Bojkoti total nisi nga e hëna. Në të njëjtin vendim, Dhoma e Avokatishë tërhoqi listën e avokatëve kryesisht nga Gjykata e Posaçme, duke e lënë atë nga mbrojtësit. Kjo do të thotë, se nëse një i arrestuar nga SPAK shkon për masë sigurie në gjykatë, ai do të mbetet pa mbrojtje, duke ju mohuar kështu një e drejtë kushtetuese. Ditën e parë të bojkotit total nga avokatët në GJKKO nuk pati masa sigurie, ndërsa nuk është e qartë si do të veprohet prej saj në ditët në vijim. Për ironi, në të njëjtën godinë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit, që ka një tjetër rregullore, proceset vijojnë normalisht.

E ndërsa avokatët kërkojnë rishikimin e rregullores dhe gjykata nga ana tjetër nuk bën hapa pas, të humburit e mëdhenj janë të pandehurit, që më së paku po ju zvarriten proceset gjyqësore. Për ata janë në masën e sigurisë "arrest në burg", me apo pa faj, po ju zgjatet koha e qëndrimit në qeli. **(A2 Televizion)**

A2 CNN **Livestream**

TE FUNDIT

Iraku kërkon rrugë të reja për eksportin e naftës pas bllokimit të Ngushticës së Hormuzit

PD kërkon pezullimin e territoriale, PS refuzon të presë konsultimet me bashkitë për hartën e opozitës

Ukraina në vështirësi financiare, i duhen edhe 20 miliardë dollarë

Manchester City rrezikon humbjen e titujve dhe përjashtim nga Premier League

MË TË VIZITUARAT



Zjarr i madh në Topojë, flakët rrezikojnë banesën



Ceremonia e çmimeve, më të mirët e Tirana International Film Festival



Përmbillet "Shkolla Rinore Ballkanike 2026", ambasadori turk: Forcojmë marrëdhëniet...

LIVE UPDATES



Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë



LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore



Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Zjarri i madh në Pogradec, flakët drejt masivit me pisha



Tantuan t'i marrin 100 mijë € kreut të FSHF, dy në pranga. Florian Gjergji në qendër të skemës



Rrjeti i drogës pranë shkollave në Tiranë, porositë dërgoheshin me monopatina, taksi dhe motorë picash



Ngacmoi seksualisht të miturën 13-vjeçare, arrestohet mësuesi në Lushnjë



Vrasja e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar, shtyhet seanca



"Barkas, barkas!" Policia arreston mashtruesit që po merrnin 100 mijë euro

Latest Videos



"Serbia po punon ditë-natë për të shpërbërë Kosovën"



Ceremonia e çmimeve, më të mirët e Tirana International Film Festival





"Prit se ta rregulloj unë" Mimoza Llastica shpluhurohet nga arkivat dhe rijetëzohet



"Duhet të gjejmë një formë për projektligjin pa dëmtuar marrëdhëniet me partnerët amerikan"

Shqipëria Aktualitet Kronikë Politikë Ekonomi Sociale Kulturë Moti	Kosova Kulturë Sociale Ekonomi Politikë Kronikë Aktualitet	Rajoni & Bota Ballkani Bota	Argëtim Showbiz Lifestyle Kapur në kamera Teknologji	Sport Live Euro 2024 Futboll Sporte të tjera	Speciale A2 5 gjëra në 5 minuta A2 CNN në Izrael 31 Minuta A2 CNN në Ukrainë Lumi i kokainës Ditari ndërkombëtar Zbulo Imagjinatë Dëshmi	
--	---	--	---	--	--	--

Live TV

[Rreth nesh](#)
[Kushtet e Privatësisë](#)
[Karriera](#)
[Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.